

TRANSFERIM NË SPITAL I NJË TË BURGOSURI TË PA DËNUAR (ME OSE PA FRENIME)

(Paragrafi 48 i Aktit të Shëndetit Mendor 1983)

1. Emri i pacientit	
2. Emri i personit përgjegjë për kujdesin tuaj (“klinikisti përgjegjës”)	
3. Emri i spitalit dhe pavijonit	
4. Data e urdhërit për transferimin tuaj	
5. Urdhëri i frenimit në funksion?	Po/Jo

Përse jam në spital?

Ju keni transferuar në këtë spital sepse Sekretari i Shtetit për Drejtësi është njoftuar nga dy mjek se ju keni çrregullim mendor dhe se keni nevojë për trajtim mjekësor.

Sekretari i Shtetit për Drejtësi e ka lëshuar një “udhëzim për transferim” sipas paragrafit 48 të Aktit për Shëndetin Mendor 1983 , i cili i lejon të burgosurit e padënuar të transferohen në spital.

Sekretari i Shtetit poashatu ju ka dhënë udhëzimi për frenim sipas paragrafit 49 të Aktit për Shëndetin Mendor.

Ç’është udhëzimi për frenim?

Nëse ju kanë dhënë udhëzimin për frenim, kjo do të thotë se ju nuk mund të liroheni nga spitali, përveç nëse Sekretari i Shtetit për Drejtësi thotë se ju mund të dilni nga spitali. Në rastin tuaj lirim nga spitali varet nga disa kushte të caktuara të cilat do t’ju shpjegohen më afër lirim tuaj. Gjatë qëndrimit në spital, përgjegjësi për kujdesin tuaj (klinikisti i juaj përgjegjës) duhet të marrë pajtimin nga Sekretari i Shtetit për Drejtësi para se të liroheni përkohshësisht ose të dërgoheni në një spital tjetër.

Sa kohë do të qëndroj këtu?

Ju do të mbaheni në spital derisa t'ju përfundon udhëzimi i transferimit.

Nëse jeni transferuar këtu **pas mbajtjes në burgim nga Gjykata Policore (Magistrates' Court)** :

ju do të mbaheni në spital deri të përfundoj periudha e mbajtjes në burg, përveç nëse ju dërgojnë në Gjykatën Mbretërore (Crown Court) për gjykim ose ktheheni prap në burg nga Gjykata Policore (meqë rast ju do të qëndroni në spital). Gjykata Policore poashtu mund të urdhëroj përfundimin e udhëzimit për transferim nëse klinicisti i juaj përgjegjës thotë se ju nuk keni më nevojë për trajtim mjekësor për çrregullim mendor në spital. Ju pastaj do të ktheheni në burg, përveç nëse gjyqi vendos t'ju liroj me garanci (bail).

Nëse jeni transferuar këtu **si i burgosur civil apo sipas ligjit të imigracionit**:

ju do të mbaheni në spital deri në datën kur do të ishit liruar nga burgu ose të ishit larguar nga qendra e ndalimit, përveç nëse klinicisti i juaj përgjegjës thotë se ju nuk keni nevojë më për mjekim. Nëse ju kanë dhënë udhëzim për frenim dhe klinicisti i juaj përgjegjës thotë se ju nuk keni nevojë më për mjekim, ju do të ktheni në burg ose qendër të ndalimit.

Në raste tjera:

ju do të mbaheni në spital derisa klinicisti i juaj përgjegjës thotë se ju nuk keni nevojë më për mjekim ose derisa rasti të shqyrtohet rasti i juaj me gjyq. Nëse klinicisti i juaj përgjegjës thotë se ju nuk keni nevojë më për mjekim, ju do të ktheheni në burg, përveç nëse gjyqi vendos t'ju liroj me garanci.

A mund të qëndroj në spital pas mbarimit të udhëzimit për transferim?

Është e mundur që t'ju mbajnë në spital sipas një paragrafi tjetër Aktit për Shëndetin Mendor nëse ju nevojitet më shumë mjekim sipas paragrafeve të ndryshme pas përfundimit të udhëzimit për transferim. Nëse po, ju do të merrni një fletëpalosje tjetër për t'ua shpjeguar këtë.

Çfarë ndodhë nëse duhet të kthehem përsëri në gjyq?

Nëse jeni kthyer në burg dhe nuk keni pas gjykim akoma, ju do të ktheheni përsëri në gjyq. Gjykata do të shqyrtoj çështjen dhe mund jep urdhër spitali sipas paragrafit 37 të Aktit për Shëndet Mendor e cila thotë se ju duhet të qëndroni në spital, ose mund t'ju jep një dënim tjetër. Gjykata mund të bëjë urdhër nëse dy mjek thojnë se ju keni çrregullim mendor dhe se ju duhet të mjekoheni sipas Aktit për Shëndet Mendor.

A mund të apeloj?

Ju nuk mund të apelon kundër vendimit të Sekretarit të Shtetit për Drejtësi për t'ju transferuar në spital, ose kundër gjyqit të ulët policor për kthim në burg.

Por ka persona që mund t'ju kërkoni leje për të dalur nga spitali.

Për ta bërë këtë ju duhet të kërkoni nga Drejtuesit e Spitalit t'ju lejnë të dilni nga spitali. Këtë mund ta bëni në çdo kohë. Drejtuesit e Spitalit janë komision i veçantë i hapur brenda spitalit për të vendosur nëse njerëzit duhet të mbahen akoma në spital. Ata do të dëshirojnë të bisedojnë me ju para se të vendosin nëse ju lejnë të dilni nga spitali. Nëse dëshironi ta bëni këtë, ju mund t'ju shkru atyre në adresën:

Ose mund të pyetni një anëtar të stafit për t'ju ndihmuar t'i kontaktoni Drejtuesit e Spitalit.

Pavarësisht se a ju kanë dhënë udhëzimin për frenim apo jo, ju mund të kërkoni nga Tribunali të thotë se u nuk duhet t'ju mbajnë në spital.

Ç'është Tribunali dhe çfarë ndodhë?

Tribunali është një kuadro e pavarur e cila mund të vendos nëse ju akoma keni nevojë për kujdestar. Ky kuadër do të mbajë një mbledhje me ju dhe me stafin që ju njeh juve. Kjo mbledhje quhet "seancë". Nëse doni ju mund të kërkoni nga një person të vjen në seancë për t'ju ndihmuar. Para seancës, anëtarët e Tribunalit do të lexojnë raportin lidhur me ju dhe kujdestarinë tuaj. Njëri nga anëtarët e Tribunalit do të vijë për të folur me ju.

Kur mund të aplikoj tek Tribunal?

Ju mund të aplikoni tek Tribunal një herë gjatë gjashtë muajve e parë, në çdo kohë, pas dhënies së udhëzimit për transferim.

Ju mund të aplikoni një herë në gjashtë muajt e ardhshëm, dhe pastaj ju mund të aplikoni një herë për çdo vit që mbaheni në spital.

Nëse nuk ju kanë dhënë udhëzim për kufizim, edhe anëtari i juaj më i afërm familjar mund të aplikoj tek Tribunali një herë gjatë gjashtë muajve të dytë, pas udhëzimit tuaj për transferim dhe pas kësaj një herë në çdo vit. Kjo fletëpalosje shpjegon më poshtë se cili është anëtari më i afërm i familjes tuaj.

Nëse doni të aplikoni tek Tribunali, ju mund t'i shkruani në adresën:

The Tribunals Service(Shërbimit i Tribunalit)
PO BOX 8793
5th Floor
Leicester
LE1 8BN
Tel. 0300 123 2201

Ju mund të kërkonte nga avokati t'i shkruaj Tribunalit për ju dhe t'ju ndihmoj në seancë. Autoriteti i shërbimeve sociale dhe shoqata e drejtësisë kanë një listë të avokatëve të specializuar për këtë çështje. Ju nuk duhet të paguani avokatin për këtë ndihmë. Ky shërbim është falas në bazë të skemës për Ndihmë Ligjore.

Çfarë ndodhë nëse Tribunali thotë se duhet t'ju mbajnë në spital?

Nëse Tribunal thotë se duhet t'ju mbajnë në spital, kjo do të thotë se ju do të ktheheni mbrapsht në burg ose në një qendër ndalimi, përveç nëse Tribunal ju ka rekomanduar që të qëndroni në spital.

Çfarë mjekimi do t'më jepet?

Klinicisti i juaj përgjegjës dhe një anëtar i stafit do të bisedojnë me ju lidhur me ndonjë mjekim të nevojshëm sipas mendimit të tyre. Në të shumtën e rasteve ju duhet të pranoni mendimin e tyre.

Pas tre muajve ekzistojnë ka rregulla tjera të veçanata lidhur me medikamentet ose ilaçet që ju jepen për çrregullimin tuaj mendor. Nëse nuk i merrni medikamentet ose ilaçet, ose jeni shumë të sëmurë për ti marrë ato, një mjek i cili nuk është nga ky spital do t'ju vizitoj. Ky mjek i pavarur do të bisedoj me ju dhe stafin e spitalit që ju njeh juve. Mjeku i pavarur do të vendos se çfarë medikamente ose ilaçe do t'ju jepen. Këto janë të vetmet medikamente dhe ilaçe që mund t'ju jepen pa pëlqimin tuaj, përveç nëse është rast urgjent.

Mjeku i pavarur quhet SOAD (Mjek i caktuar për një mendim tjetër) dhe është i caktuar nga një Komision i pavarur i cili e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor.

Ka rregulla të ndryshme për disa mjekime të veçanta, siç është terapia elektro-konvulsive (ECT). Nëse stafi mendon se ju keni nevojë për një nga këto mjekime të veçanta, do t'ju shpjegohen rregullat dhe do t'ju jepet një fletëpalosje tjetër.

Njoftimi i më të afërmit familjar

Nëse nuk keni marrë urdhër për frenim, një kopje e kësaj fletëpalosje do ti jepet një personi të cilin Akti i Shëndetit Mendor e konsideron si më të afërmin e familjes tuaj.

Është një listë e njerëzve në Aktin e Shëndetit Mendor që konsiderohen si anëtar të familjes suaj. Zakonisht, personi që është në krye të listës është anëtari më i afërt i familjes tuaj. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë dhe se çfarë të drejtash ka me i afërmi i juaj familjar në lidhje me kujdesin dhe mjekimin.

Ne jemi njoftuar se në rastin tuaj, anëtari më i afërt i familjes është:

Nëse ju nuk dëshironi që ky person të marrë një kopje të fletëpalosjes, ju lutem tregoni infermierit tuaj ose një anëtar të stafit.

Ndërrimi i anëtarit më të afërm familjar

Nëse mendon se ky person nuk është i përshtatshëm të konsiderohet më i afërmi i familjes tuaj, ju mund të aplikoni tek Gjykata e Qarkut për të konsideruar një person tjetër si më të afërmin tuaj familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë.

Letrat e juaja

Të gjitha letrat e marruara gjatë qëndrimit tuaj në spital do t'ju dorzohen juve. Ju mund t'ju dërgoni letër çdonjërit, përveç ndonjërit që ka pohuar se nuk dëshiron të marrë letra nga ju. Letrat dërguar këtyre personave mund të ndalohen nga stafi i spitalit.

Kodi Praktik

Kodi Praktik është ai që jep këshilla lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor njerëzve të përfshirë në kujdesin tuaj. Ata duhet të marrin parasysh se çfarë thot Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse doni , ju mund të kërkoni të shihni një kopje të Kodit.

Si të ankohem?

Nëse doni të ankoheni lidhur me ndonjë pakënaqësi që ka të bëjë me kujdesin dhe mjekimin tuaj në spital, ju lutem bisedoni me një anëtar të stafit. Ata mund të rregullojnë këtë çështje. Ata poashtu mund t'ju japin informacion lidhur me procedurën e ankimit të spitalit, të cilën mund të përdorni për të zgjidhur pakënaqësinë tuaj nëpërmjet të quajturit vendim lokal. Ata poashtu mund t'ju tregojnë për persona të tjerë që mund t'ju ndihmojnë për t'u ankuar.

Nëse mendoni se procedura e ankimit nuk mund t'ju ndihmon, ju mund të ankoheni tek një Komision i pavarur. Komision i pavarur e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor, për të siguruar përdorim të drejtë dhe kujdes të duhur ndaj pacientëve gjatë qëndrimit të tyre në spital. Stafi i spitalit mund t'ju jep një fletëpalosje e cila shpjegon se si të kontaktoni me Komisionin.

Ndihmë dhe informacion të mëtejshëm

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkoni nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkoni një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.